



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 2417 Prot.

Tiranë, më 24.03.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1398, datë 20.08.2009.

**SHOQËRISË "GENTARI" SH.P.K**

**Rruga "5 Maji", Tregu i Lirë, Tiranë.**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË**  
**MINIERA**

**Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria "GENTARI" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin "Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej", Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1327, datë 28.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2417, Prot., datë 02.03.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin "Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej", Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2022.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "ç" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin "Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej", Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë

sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektivin "Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej", Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ILIR BEJTJA**

